

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 10 —————>

MAJ 2022



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

Pako mbështetëse prej 100 milionë euro →

Për buletin

Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është publikim mujor i Institutit për Politika Zhvillimore – INDEP, përmes të cilit synohet informimi në detaje i qytetarëve të Kosovës rreth zbatimit të masave që i përmban Pako e Ringjalljes Ekonomike dhe pakove të tjera mbështetëse, të cilat Qeveria e Kosovës implementon për përkrahje ndaj vështirësive që pandemia COVID-19 ka sjellur në vendin tonë. Masat e integruara në këto pako kanë për qëllim lehtësimin e rimëkëmbjes ekonomike, dhe tejkalimin e problemeve që shkaktoi kjo pandemi, tek qytetarët dhe bizneset, në mënyrë që të arrihet një qëndrueshmëri e cila mundëson edhe arritjen e proceseve tjera të rëndësishme. Prandaj rëndësia e masave të

ndërmarra nga ana e Qeverisë së Kosovës në rimëkëmbjen ekonomike të vendit është shumë e madhe.

Ky edicion i buletinit, i dhjeti me rradhë, do të shtjellojë dhe do të ofrojë informacione shtesë përfshirë këtu edhe analiza sa i përket pakos mbështetëse prej 100 milionë euro që Qeveria e Kosovës miratoi dhe filloi të implementojë tash e një muaj. Kjo pako ka të alokuara rreth 100 milionë euro, të cilat do të ndahen për punëtorët e sektorit publik dhe privat, pensionistët dhe studentët. Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është i realizuar në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

KUSH JANË PËRFITUESIT E 100 MILIONË EUROVE?



Masat e reja të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, përmes të cilave synohet lehtësimi i problematikave të pandemisë, por edhe ndaj lehtësimit të përballimit të ngritjes së çmimeve janë të fokusuar tek disa kategori të qytetarëve. Kategoritë përfituese në kuadër të kësaj pako janë:

- Pensionistët
- Familjet në skemën e ndihmës sociale
- Punëtorët e sektorit publik
- Punëtorët e sektorit privat
- Studentët
- Familjet në nevojë

Këto kategori do të mbështeten me nga **100 euro, dyfishim të vlerës mbështetëse** apo me **pako ushqimore**.

Pensionistët krahas shumë s mujore që marrin, gjatë muajit prill kanë përfituar edhe 100 euro shtesë si rrjedhojë e pakos mbështetëse. Kjo nënkupton që rreth 280 mijë pensionmarrës janë përfitues nga kjo mbështetje. Këto mjete janë ndarë tashmë, pasi që me datë 15 prill 2022 është bërë ekzekutimi i mjeteve për secilin përfitues.

Familjet në skemën e ndihmës sociale, që gjithashtu janë kategori përfituese nga pako mbështetëse, kanë përfituar dyfishin e shumë s mujore që marrin zakonisht në muajt e tjerë. Mbështetja e kësaj forme është realizuar vetëm për muajin prill dhe data e ekzekutimit të këtyre mjeteve përkon me datën e mbështetjes për pensionistët, pra me 15 prill 2022. Janë gjithsej 26 mijë familje përfituese nga kjo pako.

Punëtorët e sektorit publik dhe privat do të asistohen me nga 100 euro mbështetje. Paraprkishtë, punëtorët e sektorit publik dhe privat kanë filluar aplikimin nga data 21 prill 2022. Aplikimi për mbështetje do të bëhet në mënyrë elektronike, duke plotësuar formularin me të dhënat personale të të punësuarit në vegzën në vijim: <https://apps.atk-ks.org/Subvencionim>. Ndërsa të punësuarit e sektorit publik që marrin pagë nga buxheti i shtetit nuk kanë pasur nevojë të aplikojnë sepse subvencioni prej 100 euro i është bashkangjitur pagës së muajit prill. Kushti për kualifikim për mbështetje nga kjo masë është që punëtori **të ketë qenë i deklaruar si i punësuar në periudhën tatimore shkurt 2022**. Aplikimi ka qenë i hapur deri me datë 20 maj 2022 dhe një pjesë e pagesave tashmë veq se është ekzekutuar. Përjashtim bëjnë punëtorët të cilët kanë të ardhura që tejkalojnë 1,000 euro për një muaj kalendarik.

Pjesë e pakos mbështetëse, për të cilët poashtu do të ndahen nga 100 euro janë edhe **studentët**. Aplikimi është i hapur për të gjithë studentët aktivë dhe të rregulltë të cilët ndjekin studimet në ndonjërin prej institucioneve të akredituara publike apo private të arsimit të lartë në Kosovë. Aplikimi për mbështetje bëhet në mënyrë elektronike, duke plotësuar formularin me të dhënat personale. Përfitues mund të jenë edhe studentët të cilët nuk janë shtetës të Republikës së Kosovës, por të cilët vijojnë studimet në institucionet arsimore të vendit tonë. Aplikimi për mbështetje nga kjo masë është i hapur nga data 7 maj 2022 deri më 3 qershor 2022.

Aplikimi për studentët të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës bëhet në vegëzën në vijim:
<https://ekosova.rks-gov.net/Services/SubService?service=358>



Aplikimi për studentët të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës bëhet në vegëzën në vijim:
<https://ekosova.rks-gov.net/Public/360>

Familjet në nevojë do të asistohen me pako ushqimore. Është bërë e ditur që numri i përfituesve nga kjo kategori është rreth 40 mijë familje. Përkrahja përmes pakove ushqimore vjen si rrjedhojë e lehtësimit të ngritjes së çmimeve të produkteve ushqimore bazë, por edhe si shkak i vështirësive të paraqitura nga pandemia COVID-19.

Duke parë kategoritë të cilët janë përfitues potencial nga kjo pako, numri total i përfituesve është rreth **806 mijë qytetarë**.



Kategoritë përfituese nga pako mbështetëse prej 100 milionë euro



CILI ËSHTË IMPAKTI I 100 MILIONË EUROVE TË QEVERISË SË KOSOVËS?

Efektet pozitive të kësaj mase janë evidente në kuptim të lehtësimit të barrës financiare të familjeve kosovare së paku për një periudhë një mujore dhe për të tejkaluar ngritjet enorme të çmimeve, së paku për një muaj. Poashtu, përbën një injektim në treg i cili do të përmirësoj afarizmin e bizneseve por kryesisht atyre ushqimore, meqë 100 euro nuk mjaftojnë për të nxitur investime në gjësende me vlera të larta. Mirëpo kjo shumë e parave kontribuon në mbulimin e disa hallkave të shpenzimeve mujore, të cilat tashmë me ngritjen e çmimeve të shumicës së produkteve ushqimore, derivateve dhe shërbimeve të tjera, do të ndihmojë në lehtësimin e barrës së secilës familje.


Intervenimet makroekonomike, specifkisht dhurimet në kesh dhe masat monetare jokonvencionale, transferime në formë të mallrave, financim të sigurisë sociale, dhe masa drejtuar një grupi të caktuar të popullatës, duke parë edhe shembujt e shteteve të tjera, kanë treguar rezultate pozitive. Kjo pasi që kjo shumë e të hollave, sado e vogël që mund të duket, shpërndahet tek qytetarët duke krijuar hapësira për mbulim të disa shpenzimeve, por në të njejtën kohë shumica e këtyre të hollave injektohet në ekonominë kosovare, duke bërë qarkullim të parësë brenda territorët të Republikës së Kosovës. Impakti i tillë mund të konsiderohet si pozitiv, mirëpo gjithashtu duhet të ceket se këto masa përbëjnë në thelbin e tyre vetëm arritjen e paqes sociale për një periudhë të caktuar kohore.

Pako mbështetëse do të ofronte impakt më profitabil dhe më afatgjatë nëse do të bashkërendohej me masat të cilat do të kërkonin më shumë kohë për implementimin e tyre. Disa nga format në të cilat do të mund të fokusohet pakaja mbështetëse prej 100 milionë eurove janë:

- Sigurimi i injektimeve direkte të kapitalit nëpërmjet investimeve, kredive dhe granteve.
- Injektimi i kapitalit në sistemin bankar për të nxitur investimet.
- Rritja e aktivitetit nëpërmjet strukturave të partneritetit publik-privat.
- Tërheqja e investimeve të huaja direkte hyrëse.

Këto masa përpos që do të siguronin vende të reja të punës dhe likuiditet të shtuar, do të ndihmonin Kosovën në rimëkëmbje të qëndrueshme dhe tërheqje të investitorëve të huaj potencial.

Efektet negativ i pakos mbështetëse prej 100 milionë euro është ndihma dhe impakti afatshkurtër. 100 euro për një muaj janë thjesht ndihmë për mbulimin e disa problematikave mujore të cilat janë paraqitur që nga shfaqja e COVID-19. Një shumë e tillë nuk përbënë ndihmë konkrete afatgjate, pasi që një shumë e tillë në ditët e sotme nuk mund të arrijë të mbulojë nevojat e asnjë familje kosovare. Andaj këto mjete aq sa kontribuojnë në mbulimin e disa vrimave të vogla të vështirësive mujore, nuk shërbejnë për një rimëkëmbje të duhur e as të gjelbër, duke bërë kështu Kosovën një shtet i cili nuk po synon të arrijë një rimëkëmbje të duhur.



RIMËKËMBJA E GJELBËR KRAHAS MBËSHTETJES SË NJËHERSHME PREJ 100 EURO →

Cili është dallimi mes Rimëkëmbjes së Gjellbër dhe Mbështetjes së njëhershme?

Parimet e rimëkëmbjes së gjellbër mbështesin politikat e gjellbërta dhe zbatohen për reformën ekonomike sistematike afatgjatë, që më pastaj do të mbështesin një tranzicion drejt një ekonomie globale më të qëndrueshme.

Mbështetja e njëhershme mbështet ndihmën afatshkurte, e cila mundëson tejkalimin e krizës për një periudhë shumë të shkurtër, e cila rrjedhimisht nuk mund të ofrojë rimëkëmbje të qëndrueshme.


Iniciativat e rimëkëmbjes së gjellbër përgjithësisht perceptohen si afatgjate dhe, si rrjedhim, në thelb më pak urgjente. Kjo duket veçanërisht e tillë në një kohë krize, si në pandeminë aktuale, ku vendimmarrësit e ndryshëm të buxhetit në Ministrinë e Financave dhe departamente të tjera përkatëse po fokusohen në ndikime më të menjëhershme dhe të drejtpërdrejta në ekonomi dhe mirëqenien e njerëzve. Kjo dëshmohet edhe me pakon mbështetëse prej 100 milionë eurove, por edhe me pakot paraprake, të cilat nuk përkojnë fare me rimëkëmbjen e gjellbër.

Buxheti i Kosovës është mjaft i kufizuar dhe jo i mjaftueshëm për arritjen e shumë objektivave afatgjate. Duke ditur që varfëria është rritur, ekonomia është dëmtuar rëndë e gjithashtu shumë vende pune janë humbur, masat mbështetëse për rimëkëmbje nuk përkojnë me politika të gjellbërta për arsyë të kohës së efekteve të tyre. Rimëkëmbja e gjellbër nuk tregon efekte të menjëhershme dhe një gjë e tillë po shtyn përpara masa sociale siç janë mbështetja e njëhershme prej 100 euro, si pako e fundit mbështetëse në Republikën e Kosovës. Normalisht se politikat e tilla nuk janë të duhura dhe nuk përkojnë me politikat evropiane.

100 milionë euro do të ndërtonin 100-110 MW kapacitete gjeneruese të energjisë diellore. Një masë e tillë do të kishte impakt të shumëfishtë, duke ditur që energjia diellore paraqet një nga burimet e së ardhmes për sektorin e energjisë në vendin tonë. Disa nga përfitimet e instalimit të këtij kapaciteti janë:

- Zvogëlimi i importit të energjisë elektrike
- Zvogëlimi i ndotjes së mjedisit
- Avancimi i tranzicionit energjetik
- Përsheptimi i dekarbonizimit
- Krijimi i vendeve të reja të punës
- Kursimi i parasë publike në terma afatgjate

Gjithashtu, një masë e tillë do të stimulonte investime të tjera në burimet e ripërtëritshme të energjisë elektrike, duke mundësuar Kosovën të distancohet nga thëngjilli.



PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Pako mbështetëse prej 100 milionë euro është pako stimuluuese për lehtësimin e disa hallkave të shkaktuara nga pandemia COVID-19 dhe nga ngritja e çmimeve të produkteve. Rrjedhimisht një pako e tillë nuk plotëson kërkesat e qytetarëve dhe nuk paraqet ndihmë në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike, e as të zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Ani pse numri i përfituesve paraqitet të jetë shumë i lartë, me më shumë se 800 mijë qytetarë përfitues nga kjo pako, kjo nuk do të thotë që pako ka arritur të tejkalojë krizën e shkaktuar nga faktorët e lartpërmendur.
- Pako mbështetëse prej 100 milionë euro nuk është në linjë me rimëkëmbjen e gjelbër. Kjo për faktin që nuk përmban politika të gjelbërta, por vetëm politika makroekonomike të ndarjes së parave direkt tek qytetarët. Rimëkëmbja e gjelbër do të sillte benefite të shumëfishta për Kosovën, në një periudhë më afatgjate. Ndërsa pako aktuale, është thjeshtë një ndihmë për një muaj, e cila nuk do të paraqet efekt në aspektet e rimëkëmbjes, por as në investime të tjera të cilat do të mund të shtynin përpara procese që ndërlihen me mjedisin ose krijimin e vendeve të reja të punës.
- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të shtyjë sa më shumë projekte kapitale si një mënyrë e leverdishme për të injektuar para në ekonominë e saj, e që rezulton doemos me rritje të shkallës së punësimit. Shumë projekte kapitale kanë stagnuar nëpër mekanizmat e gjykatës së tenderëve, andaj me urgjencë duhet zgjedhur këtë çështje. Projektet kapitale, e sidomos ato që ndërlihen me energjinë, sigurojnë vende të reja të punës, dhe ndihmojnë Kosovën në arritjen e objektivave afatgjate.
- Qeveria e Kosovës duhet të alokojë mjete në pako të cilat do të paraqesin efektet e tyre në periudha kohore më të gjata. Kjo nënkupton masa të gjelbërta të cilat përkojnë me rimëkëmbjen e gjelbër si një zgjidhje e duhur për tejkalimin e krizës së COVID-19. Qeveria duhet të priorizojë mbështetjen për shtimin e gjeneruesve të enegjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme. Këto projekte duhet të sigurohet që të ofrojnë vende të reja pune, diversifikim të gjenerimit, mbrojtje të mjedisit dhe tranzicion energjetik. Stimujt në pakot e ardhshme të jenë profitabile edhe për vendin por edhe për investuesit, në mënyrë që të shpejtohet rimëkëmbja dhe të arrihen objektivat e përcaktuara nga direktivat evropiane.
- Intervenimet makroekonomike, specifkisht dhurimet në kesh dhe masat monetare jokonvencionale nuk duhet të përfshihen më si masa në pakot stimuluuese. Kjo për faktin që aktivitetet ekonomike dhe aktivitetet e tjera tash e sa kohë po zhvillohen normalisht. Andaj investimet e reja, krijimi i vendeve të reja të punës dhe shumë procese të tjera të cilat janë në të mirë të mjedisit, ekonomisë dhe zhvillimit të vendit duhet të përkrahen përmes pakove të cilat mbështesin parimet e rimëkëmbjes së gjelbër. Qeveria e Kosovës duhet të shfrytëzojë rimëkëmbjen ekonomike nga pandemia në atë mënyrë që të arrihen njëkohësisht edhe procese tjera të rëndësishme për vendin tonë.



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”